Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Egzon Ademaj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor

Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës

Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 145/2021	Data: Datum: 18.05.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.01-553-11076 të datës 29.03.2021 e parashtruar nga Agim Ahmetaj nga fshati Bollopojë, Komuna e Istogut, për ndihmë financiare për blerjen e terapisë për shërim, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-553-11076 të datës 29.03.2021 e parashtruar nga Agim Ahmetaj, për ndihmë financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozim të Komisionit i ndahen 1,200.00€ (njëmijedyqind euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Agim Ahmetaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Agim Ahmetaj ka parashtruar kërkesën Nr.01-553-11076 të datës 29.03.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raporti i mjekut shihet se Agimi është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për shërim, i cili shërim është i kushtueshëm.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Agim Ahmetaj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-144/2021	Data: Datum: 17.05.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektet: Lot1 "Ndërtimi i kanalizimit në Kërrninë të Epërme"; Lot2 "Vazhdimi i kanalizimit në Lubovë për lidhje me impiantin"; Lot3 "Ndërtimi i kanalizimit në fsh. Kosh"; Lot4 "Ndërtimi i kanalizimit në fsh. Carrallukë faza II" me numër të jashtëm prokurimi 633-021-2358-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-018-521, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për vlerësimin e ofertave për projektet: Lot1 "Ndërtimi i kanalizimit në Kërrninë të Epërme"; Lot2 "Vazhdimi i kanalizimit në Lubovë për lidhje me impiantin"; Lot3 "Ndërtimi i kanalizimit në fsh. Kosh"; Lot4 "Ndërtimi i kanalizimit në fsh. Carrallukë faza II" me numër të jashtëm prokurimi 633-021-2358-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-018-521 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Naser Nimanaj,** Zyrtar i lartë për infrastrukturë rrugore, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Blerim Bujupi,** Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar dhe
- 1.3. Sami Metaj,** Zyrtar i Lartë Ligjor, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektet: si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektet e lartcekura e merr Komisioni.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen:
Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.141/2021	Data: 14.05.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 58, pika (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe nenin 14, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm publik i :

Propozon

Kuvendit të Komunës, që në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d), nenit 14 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 24 paragrafi 1, nenit 25 paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010, që në mbledhjen e mbajtur më ___/04/2021 të merr këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS PËR VARREZA

1. I jepet në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, pa kompensim, banorëve të fshatit Vrellë, sipërfaqja prej 16658 m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 102846 m² e pronës së komunës, Njesisë Kadastrale 257-0, Zona Kadastrale -Vrellë.
2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së lartcekur është destinimi vetëm për varreza të banorëve të fshatit Vrellë dhe nuk mund të shfrytëzohet për qëllime tjera.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, Drejtoria për Shërbime Publike.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në uebfaqe të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010.

Për shkak të mungesës së hapësirës së mjaftueshme për varreza, përfaqësuesi i banorëve të fshatit Vrellë, Idriz Blakaj ka parashtruar kërkesën Nr. 01-400-48498 sipas së cilës ka kërkuar t'i ndahet një pjesë e caktuar nga sipërfaqja e përgjithshme prej 102846 m² e pronës së komunës, Njesisë Kadastrale 257-0, Zona Kadastrale -Vrellë.

Me qëllim të realizimit të interesit publik propozohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh e pronës së paluajtshme të komunës ashtu siç përcaktohet në nenin 1 të këtij propozim-vendimi andaj kërkoj nga Kuvendi i Komunës miratimin e tij.

Zyrtari Ligjor,
Faton Bujupi



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.140/2021	Data: 14.05.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 58 pika (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale publikuar në (Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008) dhe nenin 68, pika 8 e Statutit të Komunës 01 Nr. 62/10 të datës 30.11.2010 i :

Propozon

Kuvendit të Komunës, që në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe 12.2, pika d), nenit 14, paragrafi 14.1 dhe 14.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale publikuar në (Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 53 dhe 57 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 27 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, që në seancën e mbajtur më ___/05/2021 të miratohet kështu:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

01 NR.87/15 të datës 30.10.2015

- Propozohet shfuqizimi i Vendimit 01 Nr.87/15 i Kuvendit të Komunës i miratuar më 30.10.2015 sipas të cilit banorëve të fshatit Vrellë, iu kishin dhënë në shfrytëzim për varreza pronat e paluajtshme të komunës, Njësia Kadastrale Nr. 369-0 dhe Nr. 74-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 20310 m², Zona Kadastrale Vrellë.
- Propozimi për shfuqizimin e vendimit të përshkruar në pikën 1 të këtij vendimi bëhet me qëllim të rikthimit në posedim të komunës të pronës së saj meqenëse banorët e fshatit Vrellë përkatësisht Xhevat Demaj më 12.05.2021 ka parashtruar kërkesën Nr. 03-016-16510 sipas së cilës ka kërkuar shfuqizimin e Vendimit 01 Nr.87/15 të Kuvendit të Komunës për shkak të parashtrimit të kërkesës së re të datës 22.10.2019 me Nr. 01-400-48498 nga përfaqësuesi i banorëve të fshatit Vrellë, Idriz Blakaj për marrjen në shfrytëzim për varreza të sipërfaqes prej 16658 m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 102846 m² e pronës së komunës, Njesisë Kadastrale 257-0, Zona Kadastrale-Vrellë.
- Pas miratimit të këtij propozim-vendimi për shfuqizim nga ana e Kuvendit të Komunës dhe dërgimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal –MAPL i njëjti hyn në fuqi ashtu siç është përcaktuar në me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 17 të Rregullores Nr. 01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në ueb faqen e Komunës.
- Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor.

Arsyetim

Sipas Vendimit 01 Nr.87/15 të Kuvendit të Komunës i miratuar më 30.10.2015, pas parashtrimit të kërkesës Nr. 03 Nr. 951-3562 më 12.10.2015 të përfaqësuesit të atëhershëm të banorëve të fshatit Vrellë, drejtuar komunës kishin kërkuar t'iu jepen në shfrytëzim për varreza, pronat e komunës, Njësitë Kadastrale: Nr. 369-0 dhe Nr. 74-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 20310 m² , Zona Kadastrale Vrellë.

Kurse më 12.05.2021 Xhevat Demaj ka parashtruar kërkesën Nr. 03-016-16510 në të cilën ka kërkuar shfuqizimi i Vendimit 01 Nr.87/15 të Kuvendit të Komunës për shkak të parashtrimit të kërkesës së re Nr. 01-400-48498 më 22.10.2019 nga përfaqësuesi i banorëve të fshatit Vrellë, Idriz Blakaj për marrjen në shfrytëzim për varreza të sipërfaqes prej 1 hektar 66 ari e 58 metra (16658 m²) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 102846 m² e pronës së komunës, Njësisë Kadastrale 257-0, Zona Kadastrale-Vrellë për arsye të mungesës së hapësirë së mjaftueshme për varreza.

Bazuar në arsyeshmërinë e këtij propozim-vendimi dhe nenin 27 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, kërkoj nga anëtarët e Kuvendit të Komunës që i njëjti të miratohet.

Zyrtari Ligjor
Faton Bujupi



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-139/2021	Data: Datum: 12.05.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: “Sistemi i Instalimit te Kamerave Brenda dhe Jashtë Objektit” (Furnizimi, Montimi dhe Instalimi i Kamerave ne Objektivin e Komunës se Istogut) me numër të jashtëm prokurimi 633-021-2182-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-015-121, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Sistemi i Instalimit te Kamerave Brenda dhe Jashtë Objektit” (Furnizimi, Montimi dhe Instalimi i Kamerave ne Objektivin e Komunës se Istogut) me numër të jashtëm prokurimi 633-021-2182-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-015-121 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Faton Bytyçi,** Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informativ, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Isa Hoxhaj,** Zyrtar i Lartë për Eficiencë të Energjisë, anëtar dhe
- 1.3. Shefqet Imeraj,** Zyrtar i Prokurimit 2, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: “Sistemi i Instalimit te Kamerave Brenda dhe Jashtë Objektit” (Furnizimi, Montimi dhe Instalimi i Kamerave ne Objektivin e Komunës se Istogut) si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartëcekur e merr Komisioni.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Administratë Komunale.

Me nga një kopje të këtij Vendimi njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Administratë Komunale dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije SUTAJ**

Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-137/021	Data: Datum: 06.05.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën Nr.09Nr.03/2021 të datës 06.05.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi për formimin e komisionit për dalje në vendin e ngjarjes për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në bujqësi e blegtori, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHEN: Komisioni për dalje në vendin e ngjarjes për vlerësimin e dëmeve të shkaktuar në bujqësi e blegtori dhe në Komision caktohen:

- 1. Daut Kabashi,** Udhëheqës i Sektorit për Pylltari, Kryesues i Komisionit;
- 2. Valbone Kaligani,** Zyrtare e Lartë për Pemëtari, anëtare; dhe
- 3. Xhevat Idrizaj,** Zyrtar për Pylltari 2, anëtar.

2. Komisioni i cekur më lartë ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha dëmeve të shkaktuara në bujqësi e blegtori; të hartojnë procesverbalin në vendin e ngjarjes dhe të kompletojnë lëndën me dëshmi-foto të dëmeve të shkaktuara; të njoftojnë Kryetarin e Komunës me ecurin e vlerësimit si dhe do t'i kryej punët dhe përgjegjësitë tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Komisioni duhet të ja filloj punës menjëherë me datën 06.05.2021 si dhe e merr përgjegjësin për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në bujqësi e blegtori.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi

Me kopje të këtij Vendim do të njoftohen: **Komisioni, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi** dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

Zekije SUTAJ

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-136/2021	Data: Datum: 05.05.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: “Blerja dhe furnizimi me gypa të kanalizimit dhe ujësjellësit”, nxjerr:

V E N D I M

- 1. CAKTOHET:** Menaxher i kontratës, **Naser Gjocaj**, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, në Drejtorinë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe **CAKTOHET:** Mbikëqyrës i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës **Enver Rugova**, Drejtor i D.SH.P.M.SH për projektin: “Blerja dhe furnizimi me gypa të kanalizimit dhe ujësjellësit” me numër të jashtëm prokurimi 633-021-676-121 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-021-005-121, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori “INTERING CONSTRUCTION” SH.P.K.
- Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
- Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.
- Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.
- Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi njoftohen: **Naser Gjocaj**, **Enver Rugova**, **INTERING CONSTRUCTION SH.P.K** dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Zyrtari Kryesor Administrativ
Enver RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.135/021	Data: 05.05.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 22 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2. të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010) dhe nenit 19 të Rregullore Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj lajmërimin 02 Nr.26/021 të datës 05.05.2021 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për pagesën e një page mujore me përfundimin e shërbimit-pensionimin e Afrim Podrimaj, nëpunës civil me titull të vendit të punës: Zyrtar për Buxhet dhe Financa 1, nxjerr:

V E N D I M

1. **KOMPENZOHE**: **Afrim Podrimaj**, nëpunës civil me titull të vendit të punës: Zyrtar për Buxhet dhe Financa 1 në Drejtorin për Buxhet dhe Financa, në lartësi prej një page mujore të cilën e ka realizuar, për shkak të pensionimit.
2. Nëpunësit civil të lartpërmendur i përfundon shërbimi me **08.05.2021**.
3. Pagesa e mjeteve të cekura në pikën 1. e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
4. Drejtoria për Buxhet dhe Financa obligohet të bëjë pagesën e një page mujore të realizuar, sipas procedurave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Menaxheri i Personelit.
6. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve të administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **Afrim Podrimaj**, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Menaxheri i Personelit, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-134/021	Data: Datum: 05.05.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 22, paragrafi 2, pika 2.4 e Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil Nr.03/L-147 dhe nenin 22, paragrafi 2 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil, Drejtoria Komunale për Arsim shqyrtoj kërkesën Nr.05-120-14421, të datës 26.04.2021, të parashtruar nga Mirjetë Beqiraj, Drejtoreshë në kopshtin e fëmijëve "Lulet e Jetës" në Vrellë, Komuna e Istogut për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes së prindit-Babait (Azem Gashi) dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- MIRATOHET:** kërkesa Nr.05-120-14421 të datës 26.04.2021, e parashtruar nga Mirjeta Beqiraj, Drejtoreshë në kopshtin e fëmijëve "Lulet e Jetës" në Vrellë, me rastin e vdekjes së prindit-babait (Azem Gashi) dhe i bëhet kompensimi në lartësi prej 345€ (treqind e katër dhjetë e pesë euro) si ndihmë familjes së lartpërmendures.
- Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1. e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transfere ose kategoria ekonomike mallra dhe shërbime.
- Zyrtari për Buxhet dhe Financa, mjetet e cekura me lartë do ti transferoj në xhirollogarinë e Mirjeta Beqiraj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij të kujdeset: Drejtoria Komunale për Arsim.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të Administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Mirjeta Beqiraj, Drejtoria Komunale për Arsim, Zyrtari për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01.Nr.133/021	Data: 05.05.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 67 pragrafi 1 nënpragrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2014) data e publikimit 18.06.2014, shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë për Arsim 05.Nr.184/2021 të datës 05.05.2021, për kompensimin në lartësi prej 3 (tri) page mujore për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Aze Kajtažaj, me titull të postit: Mësimdhënëse e mësimi klasor në Shfmu "Hysni Zajmi" në Vrellë, dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa 05.Nr.184/2021 e datës 05.05.2021, e parashtruar nga Drejtoria Komunale e Arsimit për kompensimin në lartësi prej 3 (tri) pagave mujore që i ka marr për tre (3) muajt të fundit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Aze Kajtažaj, me titull të postit: Mësimdhënëse e mësimi klasor në Shfmu "Hysni Zajmi" në Vrellë.
2. Mësimdhënësjja e lartpërmendur i përfundon shërbimi me datën 11.05.2021.
3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim.
4. Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime në Drejtorinë për Arsim, obligohet që Aze Kajtažaj, t'ia bëjë pagesën, e 3 (tri) pagave mujore që i ka marrë për tre (3) muajt të fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Arsim dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve komunale të administratës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Aze Kajtažaj, Drejtoria Komunale e Arsimit, Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe kompensime dhe një kopje mbetet në arkivën e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
HAKI RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01.Nr.132/021	Data: 05.05.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 67 pragrafi 1 nënpragrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2014) data e publikimit 18.06.2014, shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë për Arsim 05.Nr.185/2021 të datës 05.05.2021, për kompensimin në lartësi prej 3 (tri) page mujore për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Ajmane Shabanaj, me titull të postit: Mësimdhënëse e Gjuhës Shqipe në Shfmu "Trepça" në Banjë, dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa 05.Nr.185/2021 e datës 05.05.2021, e parashtruar nga Drejtoria Komunale e Arsimit për kompensimin në lartësi prej 3 (tri) pagave mujore që i ka marr për tre (3) muajt të fundit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Ajmane Shabanaj, me titull të postit: Mësimdhënëse e Gjuhës Shqipe në Shfmu "Trepça" në Banjë.
2. Mësimdhënësjja e lartpërmendur i përfundon shërbimi me datën 17.05.2021.
3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim.
4. Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime në Drejtorinë për Arsim, obligohet që Ajmane Shabanaj, t'ia bëjë pagesën, e 3 (tri) pagave mujore që i ka marrë për tre (3) muajt të fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Arsim dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve komunale të administratës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Ajmane Shabanaj, Drejtoria Komunale e Arsimit, Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe kompensime dhe një kopje mbetet në arkivën e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

